



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KESHILLI I PAVARUR MBIKËQYRES PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVES
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Anr.203/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.203/2021 të datës 31.03.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë fshati Sibovc, rruga "Ymeri", në Komunën e Obiliqit, kundër Vendimit me Nr. XII-10 të datës 01.03.2021 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Obiliqit, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 28.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.203/2021 e datës 31.03.2021 e parashtruar nga ankuesi**
- II. SHFUQIZOHET** Vendimi me Nr. XII-10 i datës 01.03.2021 i Komisionit Disiplinor të Komunës së Obiliqit.
- III. OBLIGOHET** Kryetari i Komunës së Obiliqit, që ti ndër marr të gjitha veprimet e nevojshme administrative, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke bërë kompensimin e pagës së ndaluar të ankuesit nga data e nxjerrjes së Vendimit me Nr. XII-10 të datës 01.03.2021 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Obiliqit deri në zbatimin e këtij vendimi.
- V.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit *[Emri i ankuesit]* i punësuar në Komunën e Obiliqit, sipas Akt Emërimit të datës 03.05.2021 në pozitën "Bashkëpunëtor Profesional për Gjendje Civile", Ushtruesi i detyrës së Udhëheqësit të Inspektoratit në Agjencinë e Regjistrimit Civil më datë 22.01.2021, në bazë të raportit mbi vërejtje ka vlerësuar se "gatë inspektimit të jashtëzakonshëm në datës 19.01.2021 në Zyren e Gjendjes Civile në Obiliq... gjatë kontrolli të lëndëve për personat *[Emri i lindur më 29.01.2010 në Podgoricë... si dhe i lindur më 28.01.2006 në Podgoricë, ju njoftojmë se Zyrtar i Gjendjes Civile në Obiliq z. ka bërë shkelje gjatë procedurave të regjistrimit për personat e lartcekur, pa e kompletuar lëndën (d.m.th pa pranimin e atësisë së Nënës), undaj kërkohet që ndaj ti të merren masa".*

Banuar në këtë Udhëheqësi i Gjendjes Civile në Obiliq, më datë 05.02.2021 ka paraqitur kërkesë tek Drejtoresha e Administratës së Komunës së Obiliqit duke kërkuar që zyrtari *[Emri i zyrtarit]* të qitet në Komision Disiplinor për shkak se ka bërë shkelje të rregullave ligjore të Udhëzimit Administrativ 01./2015 gjatë regjistrimit të dy fëmijëve të komunitetit rom të cilët për momentin janë me vendqëndrim në Mal të Zi dhe Drejtoresha e Administratës së Komunës së Obiliqit më datë 05.02.2021 ka kërkuar nga Menaxherja e Njesisë së Burimeve Njerëzore që lënda të procedohet në komision disiplinor dhe të merren hapat e nevojshëm.

Pas gjithë procesit Komisioni Disiplinor i Komunës së Obiliqit më datë 01.03.2021 ka nxjerr Vendim me Nr. XII-10 me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore "ndalim 20% të pagës për periudhën kohore prej 2 muajsh".

Ankuesi kundër këtij vendimi, bazuar në dispozitat e nenit 24 paragrafit 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 31.03.2021 fizikisht ka parashtruar ankesë me Nr. Prot:1500/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 02.04.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Komuna e Obiliqit. Komuna e Obiliqit më datë 12.04.2021 ka dërguar përgjigjen në ankesë me provat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 31.03.2021 me Nr. Prot: 1500/2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Dëshmi nga Libri i dorëzimi datë 01.03.2021 për ankuesin; Vendimin me Nr. XII-10 të datës 01.03.2021 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Obiliqit; Vërejtjen e datës 22.01.201 nga u.d i Udhëheqësit të Inspektoratit të ARC-së; Dekret për Ratifikim të Marrëveshjes Ndërkombëtare datë 02.09.2011; E-mailin e datës

17.12.2019 nga për ankuesin; E-mailin e datës 18.12.2019 nga për ankuesin; E-mailin e datës 18.12.2019 nga ankuesi për dhe E-mailin e datës 18.12.2019 nga për Procesverbalin i datës 11.02.2021 i Komisionit Disiplinor; Formularin për të dhënat e qytetarit datë 09.06.2020; Deklaratën e ankuesi për Shefin e Gjendjes Civile në Komunën e Obiliqit; Procesverbalin për pranimin e atësisë-amësisë i datës 1.12.2019; Dëshmitë e letërnjoftimin dhe pasaportës së Ekstraktin e Lindjes Nr. E01257107 e datës 06.06.2014; Kërkesën për regjistrim në gjendje civile i datës 11.12.2019; Formularin e intervistimit (për regjistrim në gjendjes civile) datë 11.12.2019; Fragmentin nga regjistrimi i lindjeve i Malit të Zi i datës 13.12.2017; Procesverbalin për pranimin e atësisë -amësisë i datës 30.09.2014; Dëshminë identifikimi për lëshuar nga Republika e Malit të Zi; Akt Emërimit e ankuesit i datës 03.05.2011; Përshkrimin e detyrave të punës i datës 01.02.2011; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punës i datës 26.12.2019 dhe 15.01.2020 për ankuesin; E-mailin e datës 05.02.2021 nga për për inicim procedure disiplinore; E-mailin e datës 05.02.2021 nga Muharrem Krasniqi për për inicim procedure disiplinore ndaj ankuesit; E-mailin e datës 05.02.2021 nga E-mailin e datës 08.02.2021 nga për ankuesin; Vendimin mbi emërimin e komisionit disiplinor i datës 20.11.2020; Procesverbalin e seancës së parë të komisionit disiplinor të datës 09.02.2021; E-mailin e datës 10.02.2021 nga për ankuesin; Marrëveshje ne mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Malit të Zi për regjistrimin e mëvonshëm të personave të zhvendosur nga Kosova në qëndrim në Mal të Zi, në regjistrin themeltar dhe në regjistrim e shtetasve të Republikës së Kosovës; dhe Përgjigjen në ankesë e datë 12.04.2021 e dërguar nga Komuna e Obiliqit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke u bazuar në këto rrethana, dhe pas shqyrtimit të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar që ankesa e ankuesit është e bazuar, *sepse*:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon deri tek futja në sistem të regjistrimit të dy fëmijëve ka ardhur si rezultat i presionit të zyrtarit të ARC-së dhe ndërsa kompletimin e dosjeve e ka bërë vet Udhëheqësi im në seancë të komisionit disiplinor ka deklaruar se sipas meje si udhëheqës i gjendjes civil zyrtar i cili ka bërë regjistrimin e lindjeve e çdo here në konsultë me eproret e ARC-së dhe ligjeve ne fuqi nuk e shoh që ka bërë ndonjë shkelje të ligjeve në fuqi; Andaj Komisioni Disiplinor me rastin shqyrtimit të masës disiplinore ka vepruar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, gjatë shqyrtimit të pretendimit ankimor të ankuesit i cili pretendon se deri tek futja në sistem të regjistrimit të dy fëmijëve ka ardhur si rezultat i presionit të zyrtarit të ARC-së dhe ndërsa kompletimin e dosjeve e ka bërë vet ka konstatuar që bazuar në provat e lëndës nëpunësit i Agjencisë së Regjistrimit Civil z ka përgatitur Procesverbalin për pranimin e atësisë-amësisë të datës 11.12.019 dhe Formularin për Intervistim për Regjistrim në Gjendjen Civile për personat dhe ndërsa më datë 17.12.2019 i njëjti përmes e-mailit ka kërkuar nga në cilësinë e udhëheqësit të gjendjes Civile

në Komunën e Obiliqit që *"ju lutem të kryhet procedura e regjistrimit për këtë dy persona. Këta trajtohen sipas marrëveshjes me Malin e Zi"*, mirëpo ankuesi, më datë 18.12.2019 përmes e-mailit zyrtar ka kërkuar nga _____ dhe _____ *"sqarim për këto lëndë si të vepra nga _____ më kërkohet ti regjistroj edhe pse babai është me vendbanim në Mitrovicë ndërsa për dy uënat ndryshe të fëmijëve njëra kinse në Obiliq nuk gjendet askund në libra dhe tjetra e jashtme vetëm me emër dhe mbiemër _____ nuk ka kurrfarë ekstrakti vetëm më thotë po bon hajgare"*, ndërsa _____ përmes e-mailit të njëjtën ditë i drejtohet ankuesit *"këto janë raste të Malit të zi dhe duhet të përfundohen"*.

Bazuar në provat e lartcekura dhe komunikimet mes ankuesit dhe palëve të tjera, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se përveç asaj që ankuesi ka pasur presion për regjistrimin e këtyre dy fëmijëve i njëjti këtë e ka bërë bazuar në materialin që ka përgatitur vetë nëpunësi i Agjencisë së Regjistrimit Civil i cili ka bërë vizitë në Republikën e Malit të Zi ashtu siç kërkohet me Marrëveshjen në mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Malit të Zi për regjistrimin e mëvonshëm të personave të zhvendosur nga Kosova në qëndrim në Mal të Zi, në regjistrin themeltar dhe në regjistrim e shtetasve të Republikës së Kosovës, rrjedhimisht pretendimi i ankuesit është i bazuar, sepse ankuesi çdo herë ka qenë në konsultim dhe kontakt me zyrtarët e lartcekur.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, gjatë shqyrtimit të pretendimit ankimor të ankuesit i cili pretendon se udhëheqësi im në seancë të komisionit disiplinor ka deklaruar se sipas meje si udhëheqës i gjendjes civil zyrtar i cili ka bërë regjistrimin e lindjeve e çdo herë në konsultë me eprorët e ARC-së dhe ligjeve ne fuqi nuk e shoh që ka bërë ndonjë shkelje të ligjeve në fuqi, ka konstatuar se fillimisht udhëheqësi i drejtpërdrejt i ankuesit me të pranuar raportin e datës 22.01.2021 nga ushtruesi i detyrës së Udhëheqësit të Inspektoratit në Agjencinë e Regjistrimit Civil më datë 22.01.2021, në bazë të raportit mbi vërejtje ka vlerësuar se *ankuesi ka bërë shkelje gjatë procedurave të regjistrimit për personat e lartcekur, pa e kompletuar lëndën (d.m.th pa pranimin e atësisë së Nënës), andaj kërkohet që ndaj ti të merren masa, ka pasur obligim që fillimisht të vlerësoj këtë pretendim siç parashihet me nenin 7 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, përcakton se: "Mbikëqyrësi i Drejtpërdrejtë në rastet kur vihet në dijeni të një pretendimi për shkelje disiplinore, nëpërmjet ankesave nga qytetarët apo institucione jashtë strukturave të institucionit, e vlerëson paraprakisht atë"*. Në rast se informacioni i marrë rezulton të ketë elemente si shkelje disiplinore, Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë bën kualifikimin e shkeljeve sipas nenit 46 të Ligjit siç parashihet me nenin 7 paragrafi 4 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, mbi këtë bazë nuk kemi asnjë dokument që udhëheqësi i drejtpërdrejt i ankuesit të ketë bërë vlerësimin e këtij raporti dhe varësisht nga vlerësimi se a ka elemente të shkeljes disiplinore, të bëjë kualifikimin e shkeljes së supozuar, ndërsa në e-mailin e datës 05.02.201 të dërguar për Drejtoreshën e Administratës së Komunës së Obiliqit ku përveç që ka thënë që ankuesi ka bërë shkelje të udhëzimit administrativ Nr. 01/2015, nuk ka dhënë asnjë konstatim tjetër duke mos konstatuar se cilat shkeljet të supozuar konsiderohet që ka kryer ankuesi për më tepër i është referuar një udhëzimi administrativ i cili nuk është në fuqi, rrjedhimisht nuk ka arritur të konstatoj se cilat nga shkeljet e rënda ka shkaktuar ankuesi, sepse Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, respektivisht neni 46 paragrafi 2 dhe 3 si dhe nën

paragrafët nga 3.1 deri në 3.11 përcakton që duhet të saktësohet qartë se cilat nga shkeljet i ka shkaktuar nëpunësi civil.

Po ashtu Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se udhëheqësi i drejtpërdrejt i ankuesit rastin në komision disiplinor nuk e ka iniciuar drejtpërdrejt por këtë e ka bërë duke ja dërguar Drejtoreshës së Administratës në Komunën e Obiliqit, duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e nenit 48 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil"*, e pastaj Drejtoresha e Administratës së Komunës së Obiliqit ka kërkuar nga Menaxherja e Njësisë së Burimeve Njerëzore që lënda të procedohet në komision disiplinor, në kundërshtim me legjislacionin për zyrtarët publik sepse iniciimin e procedurës disiplinore ndaj nëpunësit civil e bënë vetëm mbikëqyrësi i tij i drejtpërdrejt.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, gjatë shqyrtimit të provave të lëndës, respektivisht procesverbalin e seancës së Komisionit Disiplinor të datës 11.02.2021, në të cilën kanë marr pjesë ankuesi dhe udhëheqësi i tij i drejtpërdrejt, ndërsa gjatë deklarimeve udhëheqësi i drejtpërdrejt i ankuesit ka deklaruar se: *"Sipas meje si udhëheqës i Gj.C zyrtar i cili ka bërë regjistrimin e lindjeve e çdo herë në konsultë me eprorët e ARC-së dhe ligjeve në fuqi nuk e shoh që ka bërë ndonjë shkelje të ligjeve në fuqi"*, ka konstatuar se vërehet qartë se udhëheqësi i drejtpërdrejt i ankuesit nuk ka qenë i bindur sipas depozitave të legjislacionit që të inicoj procedurën disiplinore por këtë e ka bërë vetëm bazuar në raportin e datës 22.01.2021 të ushtruesit të detyrës së Udhëheqësit të Inspektoratit në Agjencinë e Regjistrimit Civil, rrjedhimisht pretendimet ankimore të ankuesit janë të bazuara.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke i shqyrtuar pretendimet e ankuesit se Komisioni Disiplinor me rastin shqiptimit të masës disiplinore ka vepruar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, konstaton se Komisioni Disiplinor i Komunës së Obiliqit me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr.XII-10 të datës 01.03.2021, nuk ka arritur të konstatoj drejtë gjendjen faktike dhe juridike, sepse nuk ka bërë administrimin e saktë të provave që kanë të bëjnë me rastin konkret, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 45, 46, 47 dhe 50 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 11 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.2, nenin 12 paragrafin 2 dhe 3 nën paragrafin 3.1, nenin 13 paragrafin 5 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik sepse përveç që nuk ka konstatuar saktë shkeljen e supozuar nga ankuesi ka dështuar të shqiptoj masën disiplinore. Po ashtu Vendimi me Nr.XII-10 i datës 01.03.2021 i Komisionit Disiplinor i Komunës së Obiliqit është në kundërshtim edhe me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative respektivisht nenin 48 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, 1.3 dhe 1.5 i cili përcakton se: *"Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve"*, meqenëse Vendimi me Nr.XII-10 i datës 01.03.2021 i Komisionit Disiplinor i Komunës së Obiliqit është i paqartë dhe kundërthënës është në kundërshtim me nenin 48 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Një"*

arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij”, kështu që pretendimet e ankuesit janë të bazuara.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Kryetari i Komunës së Obiliqit, është i obliguar që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke bërë kompensimin e pagës së ndaluar të ankuesit nga data e nxjerrjes së Vendimit Nr.XII-10 të datës 01.03.2021 të Komisionit Disiplinor i Komunës së Obiliqit deri në zbatimin e këtij vendimi.

Me dispozitat e nenit 21 paragrafit 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është përcaktuar se: *“Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës”,* ndërsa me dispozitat e nenit 24 paragrafit 1 të këtij ligji është përcaktuar se: *“Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit sipas nenit 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit”.*

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.203/2021

Avdi BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Obiliqit;
- Menaxherit të Personelit në Komunën e Obiliqit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.